

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

101/13
Nr.Prot.

Tiranë, më 30.12.2013



MIRATOHET
MINISTRI
LINDITA NIKOLLA

PROGRAMET E ARSIMIT BAZË

(Për klasat e shansit të dytë)

LËNDA: GJUHA SHQIPE

KLASA VI-IX

Tiranë

Dhjetor 2013

I. TË PËRGJITHSHME

Zhvillimi gjuhësor dhe letrar është themelor për rritjen intelektuale, shoqërore dhe emocionale të nxënësve dhe duhet konsideruar edhe si elementi kryesor i gjithë kurrikulës së arsimit bazë. Kur nxënësit mësojnë të përdorin mirë gjuhën, ata kanë marrë aftësitë e para e të domosdoshme për të vazhduar më tej.

Nxënësve iu nevojiten aftësitë gjuhësore, jo vetëm që të marrin informacion, të bashkëveprojnë me të tjerët dhe të shprehin veten e tyre, por edhe të tregojnë se sa të aftë e të përgatitur janë. Aftësia për të komunikuar qartë dhe saktë, me gojë dhe me shkrim, në mënyra e forma të ndryshme dhe me saktësi gramatikore e drejtshkrimore do t'i ndihmojë nxënësit që të jenë të suksesshëm edhe në botën përtej shkollës.

Duke analizuar dhe reflektuar mbi një shumëllojshmëri tekstesh letrare e joletrare, nxënësit zbulojnë botën brenda e përreth tyre dhe ndërtojnë identitetin e tyre. Nëpërmjet teksteve që lexojnë ose dëgjojnë ata mësohen të çmojnë natyrën, vlerat dhe diversitetin në shoqëri.

Mësimi i gjuhës i orienton nxënësit që të respektojnë trashëgiminë kulturore të njerëzimit, sepse një pjesë e madhe e kapitalit intelektual dhe shpirtëror të njeriut jeton në gjuhë dhe si gjuhë.

Lënda e gjuhës shqipe në klasat e shansit të dytë zhvillohet nga klasa e parë, me abetaren, deri në klasën e nëntë. Programi i gjuhës shqipe është ndërtuar mbi bazën e parimit të integritetit, e parimit të rimarrjes së njohurive, si dhe mbi bazën e parimit linear.

II. SYNIME TË LËNDËS

Gjatë katër viteve të fundit të arsimit bazë, nxënësit do të konsolidojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e tyre në gjuhë. Ata do të aftësohen që të kuptojnë, të analizojnë, të reflektojnë dhe të përdorin informacione të ndryshme në mënyrë të pavarur. Gjatë pesë viteve të para ata kanë fituar njohuritë bazë rreth gjuhës, ndaj mësimdhënia në klasat 6-9 do të ndërtohet mbi këtë themel.

Mësimi i gjuhës shqipe synon që nxënësit:

- të jenë folës dhe dëgjues aktivë dhe korrektë në situata të ndryshme komunikimi;
- të kuptojnë tekste të ndryshme letrare dhe joletrare, të përshtatshme për moshën dhe qëllimin që kanë;
- të gjejnë, krahasojnë, analizojnë e vlerësojnë informacione nga tekste të ndryshme, t'i përshtatin ato me qëllime dhe audiencë të caktuara, si dhe t'i integrojnë ato me përvojat e tyre;

- të shkruajnë tekste të ndryshme në varësi të qëllimit dhe lexuesit;
- të zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit të letërsisë dhe të bëhen të vetëdijshëm për shumësinë e mënyrave të perceptimit të botës përreth tyre;
- të aftësohen me procesin e përfutimit dhe përdorimit të informacionit dhe të mësojnë, të vlerësojnë e të përdorin shumë lloje burimesh;
- të zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e duhura rreth sistemit gjuhësor të shqipes, të cilat do t'u mundësojnë të marrin pjesë suksesshëm në jetën e përditshme.

III. LINJAT DHE NËNLINJAT E PROGRAMIT

Linja: Të dëgjuarit dhe të folurit

Nënlinjat	
1.	Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime
2.	Të dëgjuarit dhe të folurit në grup dhe në publikrreth teksteve të ndryshme.
3.	Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe gjinive letrare
4.	Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde

Linja: Të lexuarit

Nënlinjat	
1.	Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion
2.	Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate
3.	Të lexuarit e llojeve dhe të gjinive letrare për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës dhe figurat letrare
4.	Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje
5.	Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe

Linja: Të shkruarit

Nënlinjat	
1.	Të shkruarit funksional dhe për nevoja vetjake
2.	Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë
3.	Njohuri rreth gjuhës

Linja: Njohuri rreth sistemit të gjuhës

Nënlinjat	
1.	Sintaksë
2.	Morfologji
3.	Leksikologji
4.	Kulturë gjuhe
5.	Drejtshkrim dhe pikësim.

Këto linja janë të njëjta për të gjitha klasat. Shpërndarja e orëve mësimore në klasat 6-9 është:

Klasat	6	7	8	9
Orë/javë	3	3	3	3
Orë gjithsej	90	90	90	90

IV.METODOLOGJIA

Mësuesit duhet të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata duhet të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues dhe që zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm në jetën e përditshme. Disa nga këto metoda janë: *diskutim për njohuritë paraprake, analizë e tipareve semantike, diagrama piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen etj.* Ato shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënësve dhe si garanci për rezultate të mira.

Përvetësimi i programit të gjuhës shqipe bëhet cilësor, kur mësuesi mundëson që:

- nxënësit të sjellin përvoja personale, interesa, qëndrime të caktuara ndaj dukurive gjuhësore në orën e mësimi;
- ora e mësimi të shoqërohet me rubrika të pasura, paraqitje skemash dhe grafikësh të thjeshtë të tilla, si ato që nxënësi has në jetën e përditshme, pasi ndërthurja e tyre synon ta mundësojë natyrshëm integrimin.
- rimarrja të jetë pjesë e mësimi të gjuhës shqipe, me qëllim lidhjen dhe përforcimin e shprehive letrare dhe gjuhësore.
- nxënësve t'u jepen mundësi të dinë më shumë për dukuritë dhe ligjësitë gjuhësore dhe letrare.

- t'u jepet përparësi ushtrimeve, duke e kaluar mësimdhënien nga riprodhuese, në një mësimdhënie ku nxënësi kërkon, gjen, zbulon, zgjidh, analizon, provon dhe sintetizon.
- planifikimi i veprimtarive mësimore të tilla, si: të folurit në grupe, të lexuarit shprehës dhe recitimi, të shkruarit për qëllime të ndryshme dhe në fusha të ndryshme të jenë pjesë përbërëse e çdo ore mësimi.
- punët me shkrim të tipit ese, shkrim i lirë, përshkrim, portret apo modele të tjera të shkruari, edhe pse të thjeshta, të jenë të paraprirë nga njohje, analiza, imitim krijimesh të së njëjtës natyrë, shkëputur nga trashëgimia jonë dhe ajo botërore.
- kërkesa për punë me shkrim për çdo temë mësimi në procesin mësimor, të mos varet apo plotësohet vetëm nga orët e veçanta të planifikuara për to në program, por doemos të bëhet pjesë përbërëse e shtjellimit të plotë të temës përkatëse, duke shtuar edhe kërkesa që lidhen me modelimin e shkrimit.

Shënim: Mësuesit duhet të përzgjedhin metodat dhe teknikat e mësimdhënies në përshtatje me moshën e nxënësve në klasat e shansit të dytë.

V. UDHËZIME PËR PËRFAQËSIMIN E PJESËVE LETRARE DHE JOLETRARE

Gjatë mëimit të gjuhës shqipe nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë nxënësit do të lexojnë dhe shkruajnë tekste letrare dhe joletrare.

Përsa i përket përfaqësimit të teksteve letrare dhe teksteve joletrare, këshillohet të respektohen afërsisht raportet: 70% me 30%

Për tekstet letrare, udhëzohet që të zgjidhen pjesë përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe botërore në përshtatje me moshën dhe zhvillimin e nxënësve, të cilat të plotësojnë kriteret didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe qartësisë së gjuhës. Programi i gjuhës shqipe në linjën e të lexuarit, gjithashtu, parashtron përfshirjen e pjesëve letrare që mbulojnë:

- folklorin;
- letërsinë shqipe të periudhave të ndryshme;
- letërsinë botërore të periudhave të ndryshme.

Njëkohësisht këshillohet që nxënësit të lexojnë dhe analizojnë vepra dhe fragmente nga gjini të ndryshme letrare. Më konkretisht, në klasat 6-9 këshillohet të respektohen raportet: 70% prozë, 30% poezi dhe dramë.

Leximet jashtë klase

Këshillohet që përgjatë një viti shkollor të zhvillohen 2-3 vepra për lexime jashtë klase. Është e rëndësishme që gjatë këtyre orëve, nxënësve t'ju krijohet mundësia të zgjedhin edhe vepra që janë të pëlqyera e të preferuara për ta.

Veprat e rekomanduara për lexime jashtë klase duhet të jenë:

- nga letërsia shqipe dhe letërsia botërore;
- nga autorë të periudhave të ndryshme;
- nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare.

Përzgjedhja e leximeve jashtë klase nga autorë të ndryshëm, periudha të ndryshme, nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare krijon mundësi për pasurimin e përvojës letrare së nxënësve.

VI. INTEGRIMI

Një nga parimet kryesore mbi të cilat ndërtohet lënda e gjuhës shqipe është parimi i integritimit, çka do të thotë që duhet të ketë një ndërthurje të linjave dhe nënlinjave brenda orëve mësimore. Nuk duhet të ketë asnjëherë ndarje të plotë mes linjave të programit pasi ato rrjedhin nga njëra-tjetra dhe zhvillohen së bashku. Natyrisht, në orë të ndryshme mësimore linjat kanë pesha të ndryshme. P.sh. në një orë pune me shkrim, qëllimi i orës së mësimimit përqendrohet tek të shkruarit.

Lënda e gjuhës shqipe duhet integruar edhe me lëndë të tjera mësimore në arsimin bazë. Kjo do të thotë që zbatuesit e këtij programi duhet të realizojnë parimin e integritimit të njohurive dhe aftësive të gjuhës shqipe me njohuri dhe aftësi të fushave të tjera të dijeve, të tilla si: edukimi muzikor, edukimi figurativ, historia, gjeografia, gjuha e huaj, matematika, aftësimi teknologjik etj.

VII. VLERËSIMI

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënësit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e objektivave të programit për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përzgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet patur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së objektivave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;

- besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;

Vlerësimi i nxënësve ndahet në tre tipa kryesorë: vlerësimi diagnostikues, vlerësimi formues, vlerësimi përmbledhës.

Gjatë zbatimit të programit nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup, për kryerjen e detyrave të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota në regjistër për secilën prej tyre. Nga ana tjetër vlerësimi i nxënësve duhet të jetë ritmik.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me gojë, në testimet periodike me shkrim dhe në punët me shkrim, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon teste periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimi për të vlerësuar nivelin e arritjeve të nxënësve. Një formë e vlerësimit me shkrim nga nxënësit janë edhe testimet semestrale dhe përfundimtare.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Praktikrat e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve. Ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, ndërsa mësuesi rekomandon.

KLASA 6

GJUHË SHQIPE

30 javë x 3 orë në javë= 90 orë

STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

	Linja	Orë	
1.	Të folurit dhe të dëgjuarit	5	Gjuhë e folur
2.	Të lexuarit	35	Letërsi shqipe dhe botërore
			Përralla
			Tregime, novela, romane
			Poezi
			Dramë
			Folklor
			Lexime jashtë klase
3.	Të shkruarit	15	Gjuhë e shkruar
4.	Njohuri rreth gjuhës	35	Sintaksë
			Morfologji
			Leksikologji
			Kulturë gjuhe
			Drejtshkrim dhe pikësim

OBJEKTIVAT DHE PËRMBAJTJA SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

LINJA: Të dëgjuarit dhe të folurit

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat
Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime	<ul style="list-style-type: none"> - Materiale të ndryshme që japin informacion nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore. - Materiale të ndryshme të incizuara, lexime nga libra me karakter kryesisht joletrar guida, fletëpalosje, harta etj. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ndjekë me vëmendje të tjerët ose informacionin që vjen nga burime të ndryshme; • të tregojë interes për të marrë informacionin e duhur; • të interpretojë informacionin e marrë.
Të dëgjuarit dhe të folurit në grup	<ul style="list-style-type: none"> - Situata të ndryshme me tematikë nga veprimtaria e përditshme dhe me tema të tjera të rëndësishme 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të familjarizohet me të folurit në grup; • të përdorë gjuhë të përshtatshme dhe me terminologji të zgjedhur; • të ndjekë linjën e argumenteve në një diskutim; • të respektojë pika kyç të diskutimit në grup.
Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare me tema të ndryshme jetësore 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shprehë ndjenjë dhe emocion gjatë të treguarit; • të përdorë pyetjet: kush? kur? ku? si?; • të pyesë për detaje shtesë; • të shoqërojë të folurit më gjeste verbale dhe joverbale.

Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare në të cilat analizohet: struktura, elementet e saj dhe tregues të tjerë formalë. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë në poezi elemente, si: vargu, rima, strofa; • të njohë struktura të teksteve të tipit intervistë, reportazh, skicë, raport, informacion i shkurtër etj.; • të identifikojë ndryshimet mes strukturave të ndryshme të teksteve letrare dhe jo letrare.
Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe	<ul style="list-style-type: none"> - Gjuha standarde shqipe dhe dialektet janë tema të rëndësishme për të cilat mund të diskutohet dhe të mbahen qëndrime në dobi të respektimit të normës së saj. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të diskutojë rreth standardit të gjuhës shqipe; • të njohë dialektet dhe disa diferenca midis tyre; • të vlerësojë gjuhën e medias dhe të teksteve të tipit letrar dhe jo letrar.

LINJA: Të lexuarit

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat
Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion	<ul style="list-style-type: none"> - Broshura, libra të vegjël, orare, fletëpalosje, guida, harta - Burime të larmishme referencash - Materiale të shoqëruara me ilustrime etj. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë në mënyrë të kuptimshme për të marrë informacionin e duhur; • të lexojë në përshtatje me llojin e tekstit, duke respektuar intonacionin, shenjat e pikësimit etj.;

		<ul style="list-style-type: none"> të shpjegojë figurat me të cilat shoqërohen tekstet.
Të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave	- Tekste të llojit letrar të niveleve të arrira, përfaqësuese të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore të periudhave të ndryshme.	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të lexojë në mënyrë artistike dhe me ndjenjë; të kultivojë ndjenjën për të lexuar; të lexojë për të plotësuar interesa dhe dëshira vetjake.
Të lexuarit për të reflektuar mbi idetë e pjesës	- Vepra të letërsisë shqipe dhe të letërsisë botërore të periudhave të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e nxënësve.	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të lexojë tekste të llojeve të ndryshme letrare e joletrare, si në poezi e prozë; të lexojë qartë dhe me shqiptim të saktë; të zbulojë figurat letrare (epiteti, krahasimi, metafora) të teksteve të ndryshme; të zbulojë moralin e një fabule.
Të lexuarit e llojeve dhe gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> Tekste të llojeve të ndryshme, si: poemë, poezi, dramë, tregim etj. Tekste të tipit informativ për të bërë krahasime midis teksteve letrare dhe atyre jo letrare. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshtatet gjatë leximit me mënyrën specifike të leximit të llojeve dhe gjinive letrare; të krahasojë tekstet letrare me ato joletrare; të ritregojë përmbajtjen e teksteve të ndryshme.

Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë të incizuara - Tekste që janë të mundshme për t'u dramatizuar dhe luajtur në role nga nxënësit 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë me zë të lartë dhe me intonacionin e duhur; • të mësojë përmendsh pjesë të shkurtra; • të interpretojë në grupe të vogla dhe në grupe të mëdha.
Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe	<ul style="list-style-type: none"> - Tema, karakteret, vendosja e marrëdhënieve, plani i pjesës janë terma që do t'i shtohen tashmë analizave të nxënësve në lidhje me tekstet që lexojnë. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të respektojë gjatë të lexuarit rregullat e drejtshqiptimit të strukturave morfologjike; • të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja të ndryshme.

LINJA: Të shkruarit

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat
Të shkruarit funksional	Lloje dhe modele shkrimi të të shkruarit tilla, si: <i>udhëzime, njoftime, intervista, ese etj.</i>	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë për një gjerësi lexuesish: për mësuesin, për prindërit, për shokët; • Të shkruajë për t'iu përgjigjur një fushe të gjerë aktiviteteve të shkruarit të tilla, si: <i>udhëzime, njoftime, intervista, ese;</i> • Të shkruajë për të dhënë informacion për të tjerët.

Të shkruarit personal (për nevoja vetjake)	Forma të tilla të shkruari, si: <i>letrat formale dhe personale, shënime, ditar etj.</i>	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të zhvillojë stilin e tij personal; • të shkruajë duke përdorur imagjinatën e tij; • të shkruajë letra formale; • të shkruajë letra joformale; • të shkruajë një fletë ditari.
Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë	Histori të reja nga bota, hapësira reale dhe jo reale të shfaqura në TV, video, radio etj.	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë me ndjenjë heronjtë e tij imagjinarë; • të gjejë mbyllje tregimesh sipas imagjinatës së tij.
Njohuri rreth gjuhës	Terminologji gjuhësore, si: paragrafi , mbiemrat, lidhëzat, ndajfoljet dhe fjalë të tjera ndihmëse	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë saktë mbiemrin, ndajfoljen, lidhëzat; • të respektohet gjinia, numri e kategori të tjera gramatikore gjatë shkrimit të fjalëve; • të respektohet paragrafi si kërkesë e rëndësishme në shkrime të llojeve të ndryshme.

LINJA: Njohuri rreth gjuhës

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat
Sintaksa	<ul style="list-style-type: none">- Fjalë, përbërësit, funksionet- Fjalë e thjeshtë: grupi emëror, grupi foljor- Kryefjalë- Kallëzuesi- Përcaktori- Kundrinori- Rrethanori- Fjalë e thjeshtë dhe e përbërë	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none">• të dallojë grupet e fjalëve në një fjali;• të gjejë grupin emëror dhe grupin foljor në fjali;• të gjejë kryefjalën e shprehur me emër, përemër dhe grup emëror;• të gjejë kallëzuesin;• të dallojë përcaktorin;• të dallojë kundrinorin;• të dallojë rrethanorin e kohës, vendit, mënyrës, shkakut, qëllimit sasisë të shprehur me ndajfolje;• të përdorë rrethanorin në fjali;• të dallojë fjalitë sipas ndërtimit: e thjeshtë, e përbërë.

Morfologjia	<ul style="list-style-type: none"> - Klasat e fjalëve; grupi emëror - Emri; veçoritë gramatikore - Përcaktuesit e emrit - Mbiemri - Përemri vetor, dëftor dhe pronor - Folja, mënyra dëftore - Ndajfolja - Lidhëzat 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë gjininë e emrit: femërore, mashkullore, asnjëse; • të lakojë emrin; • të lakojë përemrin vetor; • të gjejë trajtat e shkurtra të përemrit vetor; të dallojë përemrat pronorë; • të dallojë përemrat dëftorë; • të zgjedhë foljen në mënyrën dëftore; • të dallojë ndajfoljet; • të dallojë lidhëzat.
Leksikologjia dhe fjalëformimi	<ul style="list-style-type: none"> - Shprehjet frazeologjike - Sinonimet, antonimet dhe homonimet 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë shprehjet frazeologjike; • të përdorë shprehje frazeologjike në një fjali; • të dallojë sinonimet, antonimet dhe homonimet.
Kultura e gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi dhe gjuha 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të njohë funksionet e komunikimit.
Drejtshkrimi dhe pikësimi	<ul style="list-style-type: none"> - Takimi i dy shkronjave të njëjta (zanore ose bashkëtingëllore) - Drejtshkrimi i fjalëve me <i>e</i> të theksuar e të patheksuar 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë saktë fjalët që e kanë shkronjën enë pozicione të ndryshme; • të shkruajë saktë fjalët që e kanë shkronjën ë në pozicione të

	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i fjalëve me <i>ë</i> të theksuar dhe me <i>ë</i> të patheksuar; <i>ë</i>-ja pastheksore; <i>ë</i>-ja fundore - Grupet ye, ua, ue - Apostrofi - Shenjat e pikësimit në fund të fjalisë 	<p>ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë drejt fjalët kur takohen dy shkronja të njëjta; • të shkruajë drejt fjalët që përmbajnë grupet e zanoreve: ye, ua, ue; • të përdorë drejt apostrofin te trajtat e shkurta, përemri pyetës ç; • të përdorë drejt shenjat e pikësimit në fund të fjalisë.
--	--	---

KLASA 7

GJUHË SHQIPE

30 javë x 3 orë në javë= 90 orë

STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

	Linja	Orë	
1.	Të folurit dhe të dëgjuarit	5	Gjuhë e folur
2.	Të lexuarit	35	Letërsi shqipe dhe botërore
			Përralla
			Tregime, novela, romane
			Poezi, poemë
			Dramë
			Folklor
			Lexime jashtë klase
3.	Të shkruarit	15	Gjuhë e shkruar
4.	Njohuri rreth gjuhës	35	Sintaksë
			Morfologji
			Leksikologji
			Kulturë gjuhe
			Drejtshkrim dhe pikësim

OBJEKTIVAT DHE PËRMBAJTJA SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

LINJA: Të dëgjuarit dhe të folurit

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat
Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime	<ul style="list-style-type: none"> - Materiale të ndryshme të shkruara për qëllime të ndryshme, që japin informacion dhe nxisin diskutime nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore. - Materiale të ndryshme: gazeta, revista, lexime nga libra me karakter kryesisht joletrar si: guida, fletëpalosje, harta etj. - Tema të mundshme orientimi në treg, stacionin e trenit, në aeroport, në mjedise publike, sportive, ekspozita, biblioteka, koncerte etj. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ndjekë me vëmendje bashkëbiseduesin ose informacionin që vjen nga burime të ndryshme TV, radio, video etj.; • të respektojë bashkëbiseduesin; • të interpretojë informacionin e marrë duke e shoqëruar edhe me informacion shtesë që mund ta ketë vetë nxënësi; • të japë këshilla ose udhëzime të nevojshme; • të plotësojë e pasurojë më tej këshillat ose udhëzimet e të tjerëve.
Të dëgjuarit dhe të folurit në grup	<ul style="list-style-type: none"> - Situata të ndryshme me tematikë nga veprimtaria e përditshme dhe me tema të tjera të rëndësishme që kërkojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve dhe nxisin të folurit në grupe të vogla dhe të 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshtasë të folurit e vet për situata reale komunikimi në grup; • të jetë aktiv gjatë të folurit në grup për tema që i interesojnë; • të respektojë të folurit e të tjerëve në situata grupi; • të japë mendime alternative;

	mëdha.	<ul style="list-style-type: none"> • të përdorë gjuhë të përshtatshme; • të respektojë pikat kyç të diskutimit në grup.
Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme	– Situata reale komunikimi që kanë të bëjnë me përvoja të ndryshme, me ndjenja dhe mendime të shprehura për çështje të ndryshme, të cilat zgjidhen nga leximet dhe përvojat vetjake.	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shprehë përvoja vetjake për probleme të ndryshme; • të shfaqë mendime rreth përvojave të shprehura prej të tjerëve; • të shprehë ndjenjë dhe emocion gjatë të treguarit; • të organizojë diskutimin duke i vendosur idetë qartë dhe kuptueshëm; • të përdorë pyetjet: <i>Kush?, kur?, ku?, si?, sa?</i> kur diskuton për t'u bërë më bashkëpunues në grup; • të pyesë për detaje shtesë.
Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare	<p>– Tekste të ndryshme letrare dhe joletrare në të cilat analizohen: struktura, elementet e saj dhe tregues të tjerë formalë</p> <p>– Tekste të llojeve të ndryshme për të bërë krahasime</p>	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të krahasojë poezinë me prozën; • të krahasojë disa elemente gjuhësore të teksteve të tipit: <i>intervistë, reportazh, skicë, raport etj.</i>; • të tregojë ndryshimet mes formateve të ndryshme të teksteve letrare dhe joletrare.
Njohuri rreth gjuhës standarde	– Diskutime rreth respektimit të normës së gjuhës shqipe dhe të dialekteve	<ul style="list-style-type: none"> • të diskutojë rreth standardit të gjuhës shqipe; • të krahasojë dialektet e gjuhës shqipe.

shqipe		
--------	--	--

LINJA: Të lexuarit

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat
Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste, broshura, libra të vegjël, orare, fletëpalosje, guida. - Materiale të shoqëruara <i>me grafikë, , diagrame, ilustrime etj.</i> - Informacione shkencore, revista 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të bëjë pyetje analizuese për të zbuluar domethënien e teksteve të ndryshme; • të lexojë duke respektuar shenjat e pikësimit sipas llojit të tekstit etj.; • të lexojë duke shpjeguar <i>pikturat,ngjyrat, grafikët, diagramet etj.</i>, me të cilat shoqërohen tekstet; • të zbulojë detaje të rëndësishme në një tekst informativ.
Të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste të llojit letrar të niveleve cilësore, përfaqësuese të letërsisë shqipe dhe botërore të kohërave të ndryshme. - Poezi, prozë, dramë 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë në mënyrë artistike dhe me ndjenjë; • t'i ngjallet dashuria për të lexuar letërsi artistike; • të lexojë duke e përzgjedhur materialin sipas interesave dhe dëshirave të veta.
Të lexuarit për të mbajtur qëndrim për	<ul style="list-style-type: none"> - Vepra të letërsisë shqipe dhe botërore të kohërave të ndryshme dhe të 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë tekste të llojeve të ndryshme letrare e joletrare, si: <i>poezi</i>

idetë e pjesës dhe figurat letrare	<p>përshtatshme për moshën e nxënësve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Paraqitja e figurave bazë letrare: <i>epitet, krahasim, metafora, simboli, hiperbola.</i> 	<p><i>prozë, dramë, revista;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë në mënyrë të qëllimshme; • të kuptojë nëpërmjet tekstit, mesazhet që përcillen në nëntekstin e tij; • të dallojë figurat letrare (epitet, krahasim, metaforë, simbol, hiperbolë) gjatë leximit dhe komentimit të pjesëve; • të analizojë personazhet.
Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste të llojeve të ndryshme, si: <i>poemë, poezi, novelë, roman, dramë, tregim.</i> - Tekste të tipit informativ për të bërë krahasime me tekste të tipit letrar. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të grupojë pjesët që lexon sipas gjinive letrare; • të tregojë ndryshimet mes gjinive letrare; • të krahasojë tekstet letrare dhe joletrare; • të analizojë subjektin; • të bëjë përmbledhje të shkurtra rreth teksteve që lexon.
Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë të regjistruara. - Tekste që janë të mundshme për t'u luajtur me role nga nxënësit. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë me zë të lartë dhe me intonacionin e duhur; • të lexojë në heshtje, në mënyrë të qëllimshme; • të interpretojë pjesë letrare të llojeve të ndryshme.
Të lexuarit në praktikim të	<ul style="list-style-type: none"> - Terma që do t'i shtohen analizave të nxënësve në lidhje me tekstet që 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të respektojë gjatë të lexuarit rregullat e drejtshqiptimit të strukturave

njohurive rreth gjuhës standarde shqipe	lexojnë, si: tema, karakteret, vendosja e marrëdhënieve, idetë, plani i pjesës, figuracioni letrar.	morfologjike; <ul style="list-style-type: none"> • të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja; • të përdorë fjalorë për shpjegimin e fjalëve të vështira dhe të panjohura; • të përdorë bibliotekën dhe internetin.
---	---	--

LINJA: Të shkruarit

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat
Të shkruarit funksional	Lloje dhe modele shkrimi të shkruari si: përmbledhje, artikuj për gazetadhe ese përshkruese	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë për lexues të ndryshëm; • të shkruajë <i>përmbledhje, artikuj për gazeta dhe ese përshkruese.</i>
Të shkruarit për nevoja vetjake	Forma të tilla të shkruari, si: <i>letrat formale dhe joformale.</i>	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të bëjë shkrime personale, si: letra formale dhe joformale për qëllime dhe audienca të ndryshme; • të përshkruajë përvoja vetjake; • të përshkruajë veprimtari të kryera në grup.

Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë	<ul style="list-style-type: none"> - Histori të reja nga bota - Tregime imagjinare - Shkrime shkencore - Shënime udhëtimi 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë heronjtë e tij imagjinarë; • të gjejë hyrje tregimesh sipas imagjinatës së tij; • të gjejë mbyllje tregimesh sipas imagjinatës së tij.
Njohuri rreth gjuhës	<p>Terminologji gjuhësore, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Titulli - Paragrafi - Mbiemrat, ndajfoljet, lidhëzat - Struktura e fjalisë - Shenjat e pikësimit - Hyrja, zhvillimi, mbyllja 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të respektojë kërkesat gjuhësore sipas llojit të modelit të shkrimit; • të respektojë paragrafin si kërkesë e rëndësishme në shkrimet e tij; • të respektojë shenjat e pikësimit; • të qortojojë shkrimin e vet.

LINJA: Njohuri rreth gjuhës

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat
Sintaksë	<ul style="list-style-type: none"> - Grupi i kryefjalës - Përcaktori, mënyrat e shprehjes - Kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë - Rrethanori i vendit dhe i kohës - Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë funksionet gramatikore të fjalëve; • të përcaktojë mënyrat e shprehjes së përcaktorit; • të gjejë dhe të shpjegojë kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë; • të gjejë dhe të shpjegojë rrethanorin e vendit dhe të kohës;

	<ul style="list-style-type: none"> - Rrethanori i mënyrës dhe i sasisë - Fjalja e thjeshtë dhe e përbërë - Fjalitë me bashkërenditje dhe nënrenditje - Fjalitë me bashkërenditje 	<ul style="list-style-type: none"> • të gjejë dhe të shpjegojë rrethanorin e shkakut e të qëllimit; • të gjejë dhe të shpjegojë rrethanorin e mënyrës e të sasisë; • të dallojë fjalitë e thjeshta dhe të përbëra; • të dallojë fjalitë me bashkërenditjedhe nënrenditje; • të grupojë fjalitë me bashkërenditje.
Morfologji	<p>Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Format e foljes: veprorë dhe joveprorë - <i>Mënyrat e foljes</i> - Mënyra dëftore, kohët - Mënyra lidhore, kohët <p>Përemri dhe llojet e tij</p> <p>Mbiemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshtatja me emrin në gjini, numër e rasë - Shkallët e mbiemrit <p>Lidhëzat</p>	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojë foljet e formës veprorë dhe joveprorë; • të dallojë mënyrat e foljes; • të dallojë foljet në mënyrën dëftore dhe kohët e saj; • të dallojë foljen në mënyrën lidhore dhe kohët e saj; • të dallojë përemrin dhe llojet e tij; • të dallojë mbiemrin dhe veçoritë e tij gramatikore; • të dallojë shkallët e mbiemrit; • të dallojë lidhëzat.

Leksikologji dhe fjalëformim	<ul style="list-style-type: none"> - Fjala dhe përbërësit e saj - Fjalët e prejardhura, të përbëra, të përngjitura - Homonimet - Fusha leksikore - Familja e fjalëve - Sinonimet dhe antonimet 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të analizojë fjalën sipas përbërësve të saj; • të dallojë parashtesat dhe prapashtesat dhe të krijojë fjalë të prejardhura prej tyre; • të krijojë fjalë të përbëra; • të gjejë fjalë të përngjitura dhe të dallojë pjesët përbërëse; • të njohë fushat semantike të fjalëve; • të dallojë kuptimin e parë të fjalëve dhe kuptimin e figurshëm; • të krijojë familje fjalësh; • të gjejë e të dallojë fjalë sinonime dhe antonime.
Kulturë e gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> - Fjalorët - Dialektet e gjuhës shqipe - Gjuha standarde shqipe 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë fjalorët për interesa mësimore; • të dallojë dialektet e gjuhës shqipe dhe disa veçori të tyre; • të dallojë fjalën shqipe nga fjala e huaj.

<p>Drejtshkrim dhe pikësim</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund dhe në trup të fjalës - Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve <i>b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh</i> para dhe pas zanoreve. - Sh-, zh-, ç- nistore - S-, z- nistore - Shkrimi i j-së - Shkrimi i bashkëtingëllores <i>h</i> - Fjalët me rr - J-ja në trup dhe në fund të fjalës - Grupet e bashkëtingëlloreve <i>mb, ng, nd, ngj</i> - Takimi i dy shkronjave të njëjta, të tipit: <i>alkool</i> etj. - Drejtshkrimi i fjalëve të huaja - Përdorimi i dy pikave, i thonjëzave dhe kllapave 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë drejt bashkëtingëlloret e zëshme në <i>fund dhe në trup të fjalës</i>; • të shkruajë drejt fjalët me bashkëtingëlloret <i>b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh</i> para dhe pas zanoreve; • të shkruajë drejt <i>sh-, zh-, ç-</i>nistore; • të shkruajë drejt <i>s-, z-</i> nistore; • të shkruajë drejt j-në; • të shkruajë drejt bashkëtingëlloren <i>h</i>; • të shkruajë drejt fjalët me <i>rr</i>; • të shkruajë drejt j-në në trup dhe në fund të fjalës; • të shkruajë drejt grupet e bashkëtingëlloreve <i>mb, ng, nd, ngj</i>; • të shkruajë drejt takimet e dy shkronjave të njëjta fjalë të tilla, si: <i>alkool</i> etj.; • të shkruajë drejt fjalët e huaja; • të përdorë saktë dy pikat, thonjëzat dhe kllapat.
--------------------------------	--	--

KLASA 8

GJUHË SHQIPE

30 javë x 3 orë në javë= 90 orë

STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

	Linja	Orë	
1.	Të folurit dhe të dëgjuarit	5	Gjuhë e folur
2.	Të lexuarit	35	Letërsi shqipe dhe botërore
			Tregime, novela, romane
			Poezi, poemë
			Dramë
			Folklor
			Lexime jashtë klase
3.	Të shkruarit	15	Gjuhë e shkruar
4.	Njohuri rreth gjuhës	35	Sintaksë
			Morfologji
			Leksikologji
			Kulturë gjuhe
			Drejtshkrim dhe pikësim

OBJEKTIVAT DHE PËRMBAJTJA SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

LINJA 1: Të dëgjuarit dhe të folurit

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat
